



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:105074

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05785377

**PKR.nr.404/20**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda**, nga trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët **Drilon Haraçia** - Kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve profesional – **Nikollë Komani dhe Driton Sadiku** - anëtarë të trupit gjykues, me zyrtares ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarve L. J. dhe V. J. që ty dy nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë dhe në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPRK-së, si dhe i akuzuari L.J., për shkak të veprës penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda PP/L.nr.90/2020, të datës 18.11.2020, tani e përfaqësuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe shpalljes së vendimit me datën 30.04.2024 dhe pas përpilimit të aktgjykimit të dt.28.05.2024, **jashtë seancës sipas detyrës zyrtare, me dt.05.06.2024** këtë:

### A K T V E N D I M

**PËRMIRËSOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Krimeve të Rënda me numër PKR.nr.404/20 i datës 28.05.2024, **ashtu që në faqen e tretë tek dispozitivi tek pjesa gjykuese, pasusi i parë ku është shënuar në kohëzgjatje prej “njëzet e” dy (2) vite, e 7 (shtatë), duhet të hiqet (njëzet e) ajo pjese pasi që është bërë gabim teknik gjatë përpilimit të aktgjykimit, e që duhet të jetë “dy (2) vite e 7 (shtatë) muaj”. Po ashtu në pasuesin e tretë të njëjtës faqe ku është shënuar në kohëzgjatje prej “dymbëdhjetë (2) vite, e 6 (gjashtë) muaj, duhet të hiqet (dymbëdhjetë) ajo pjese pasi që është bërë gabim teknik gjatë përpilimit të aktgjykimit, e që duhet të jetë “dy (2) vite e 6 (gjashtë) muaj”.**

Ndërsa në pjesët tjera aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin me numër PKR.nr.404/20 i datës 28.05.2024, i ka shpallur fajtor të akuzuarit L. J. dhe V. J. që ty dy nga Mitrovica, për shkak të veprës penale Vrasje në tentativë dhe në bashkëkryerje nga neni 172 lidhur me nenin 28 dhe nenin 31 të KPRK-së, si dhe i akuzuari L.J., për shkak të veprës penale Mbjtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjatë përpilimit të aktgjykimit është përvjedhur një gabim teknik, ashtu që ashtu që në faqen ashtu që në faqen e tretë tek dispozitivi tek pjesa gjykuese, pasusi i parë ku është shënuar në kohëzgjatje prej “njëzet e” dy (2) vite, e 7 (shtatë), duhet të hiqet (njëzet e) ajo pjese pasi që është bërë gabim teknik gjatë përpilimit të aktgjykimit, e që duhet të jetë “dy (2) vite e 7 (shtatë) muaj”. Po ashtu në pasuesin e tretë të njëjtës faqe ku është shënuar në kohëzgjatje prej “dymbëdhjetë (2) vite, e 6 (gjashtë) muaj, duhet të hiqet (dymbëdhjetë) ajo pjese pasi që është bërë gabim teknik gjatë përpilimit të aktgjykimit, e që duhet të jetë “dy (2) vite e 6 (gjashtë) muaj”.

Këto pjesë permisohen pasi që është bërë gabim teknik gjatë përpilimit të aktgjykimit, prandaj gjykata sipas detyrës zyrtare ka bërë përmirësimin e këtij aktgjykimi.

Siç u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 371 par.1 të KPP.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**Departamenti i Krimeve të Rënda**  
**PKR.nr.404/20, me datë 05.06.2024**

**Zyrtarja Ligjore,**  
**Arbënore Basha**

**Kryetari i Trupit Gjykuës- Gjykatësi,**  
**Drilon Haraçia**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktvendimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.